# MANUALI I PËRDORIMIT

## eKrum-Web

tretek

# Përmbajtja


1. Hyrje 3
2. Krijimi i llogarisë 4
   2.1. Aktivizimi i llogarisë 5
3. Kyçja në sistem 6
4. Fjalëkalimi i harruar 7
5. Shtimi i pronave 8
   5.1 Detajet e pronave 9
6. Ballina e sistemit 10
   6.1 Fusha e kërkimit 11
   6.2. Grafiku i Përdorimit dhe Kostos 12
   6.3. Tabela e Transaksioneve 13
      6.3.1. Detajet e Pagesave 14
      6.3.2. Detajet e Faturave 15
7. Menuja e Transaksioneve 16
   7.1. Transaksionet 17
8. Pagesa Online 18
   8.1. Zgjedhja e Shumës për pagesë 19
   8.2. Procesi i verifikimit të llogarisë bankare 20
9. Njoftimet 21
10. Cilësimet 22
   10.1. Llogaria juaj 23
   10.2. Menaxho pronat 24
   10.3. Siguria e llogarisë 25
   10.4. Cilësimet e njoftimeve 26
   10.5. Gjuha 27
11. Çkyçja nga sistemi 28


tretek

# 1. Hyrje

- Përdoruesi duhet të qaset në sistem përmes një shfletuesi interneti si **Google Chrome**, **Mozilla Firefox** ose **Microsoft Edge**.
- Në fushën e adresës shkruhet linku i sistemit
- Shtypet tasti **Enter**.
- Pas kësaj, hapet faqja e kyçjes në sistem.




tretek

# 2. Krijimi i llogarisë

- Hapni faqen e sistemit.
- Poshtë butonit **“Hyr”**, klikoni në **“Regjistrohu këtu”**.
- Shkruani **emrin dhe mbiemrin** tuaj.
- Vendosni **email-in**, **numrin e telefonit** dhe **numrin personal**.
- Krijoni një **fjalëkalim** dhe konfirmoni atë.
- Pranoni kushtet duke vendosur shenjën ✔ .
- Në fund, klikoni butonin **“Krijo llogari”**.

- Në fund, shtypni butonin **“Regjistrohu”** për të krijuar llogarinë tuaj.




tretek

# 2.1 Aktivizimi i llogarisë

- Pas regjistrimit, do t’ju vijë një **email për konfirmim**.
- Hapeni email-in dhe klikoni për ta **konfirmuar**.
- Pas konfirmimit, llogaria juaj do të jetë e **aktivizuar**.

Nëse butoni për verifikim nuk funksionon, klikoni në linkun që do t’ju dërgohet në fund të email-it.




tretek

# 3. Kyçja në sistem

- Në faqen e kyçjes, përdoruesi duhet të vendosë:
- **Email-in**
- **Fjalëkalimin**
- Pas plotësimit të të dhënave, klikoni butonin **“Hyr”** për të hyrë në sistem.




tretek

# 4. Fjalëkalimi i harruar

- Nëse përdoruesi ka harruar fjalëkalimin, mund të përdorë opsionin **“Harruat fjalëkalimin?”**.
- Pas vendosjes së email-it tuaj, sistemi do t’ju dërgojë një email për vendosjen e një fjalëkalimi të ri.




tretek

# 5. Shtimi i pronave

Pas hyrjes në sistem, përdoruesi dërgohet në faqen kryesore (Dashboard), por meqë nuk ka asnjë pronë të regjistruar, përdoruesi duhet të regjistrojë vetë pronën e tij.

Për ta shtuar pronën, klikoni butonin **“Shto pronë”.**




tretek

# 5.1 Detajet e pronave

Në këtë pjesë, përdoruesi duhet të vendosë kodin e pronës (Kodin e Klientit) ose kodin e faturës përkatëse, në mënyrë që të shtojë pronën në sistem.

Pas vendosjes, përdoruesi duhet të klikojë butonin **“Shto pronë të re”.**






# 6. Ballina e sistemit

Pas shtimit të pronave, përdoruesit do t’i shfaqen të dhënat kryesore të llogarisë si:

- Lart paraqitet profili i përdoruesit me njoftime dhe opsione
- Poshtë shfaqet prona me: emrin, adresën dhe borxhin aktual
- Në qendër paraqitet fatura e fundit me: shumën, afatin, borxhin total dhe butonin **“Paguaj tani”**
- Seksioni “**Transaksionet**” përfshin listën e pagesave/faturave me detaje dhe filtrim (Të gjitha, Faturat, Pagesat)
- Poshtë ndodhet menuja e navigimit:
    - **Ballina,**
    - **Pagesa,**
    - **Transaksionet**




tretek

# 6.1. Fusha e Kërkimit

Në pjesën e sipërme ndodhet fusha e kërkimit, përmes së cilës përdoruesi mund t’i kërkojë pronat duke shkruar emrin, adresën apo të dhëna të tjera të lidhura me to.




tretek

# 6.2. Grafiku i Përdorimit dhe Kostos

Në vijim paraqitet një grafik që tregon përdorimin e ujit dhe kostot për secilin muaj, duke mundësuar një pasqyrë të qartë të shpenzimeve gjatë vitit.




tretek

# 6.3. Tabela e Transaksioneve

Ky seksion paraqet **katër transaksionet ose pagesat e fundit** të përdoruesit, me detaje kryesore për secilin transaksion dhe mundësinë për të parë informacion shtesë përmes opsionit **“Shiko detajet”**.




tretek

# 6.3.1. Detajet e Pagesave

Kur përdoruesi klikon **“Shiko detajet”** te një transaksion i llojit **“Pagesa”**, hapet një dritare ku paraqiten informacionet e detajuara të pagesës, si lloji i transaksionit, data, shuma, numri i dokumentit dhe përshkrimi i pagesës.




tretek

# 6.3.2. Detajet e Faturave

Kur përdoruesi klikon “Shiko detajet” te një transaksion i llojit **“Fatura”,** hapet një dritare ku paraqiten informacionet e detajuara të faturës, si gjendja aktuale dhe paraprake e matësit, dallimi në $m^3$, data, kodi i matësit dhe shuma totale për pagesë.



# 7. Menuja e Transaksioneve

Kur përdoruesi klikon “Shiko detajet” te një transaksion i llojit **“Fatura”,** hapet një dritare ku paraqiten informacionet e detajuara të faturës, si gjendja aktuale dhe paraprake e matësit, dallimi në $m^3$, data, kodi i matësit dhe shuma totale për pagesë.




tretek

# 7.1. Transaksionet

- Në këtë pjesë paraqitet historia e faturimit dhe pagesave për pronën e zgjedhur
- Shfaqen të gjitha transaksionet (faturat dhe pagesat) me detaje si data, shuma dhe konsumi
- Përdoruesi mund të kërkojë dhe filtrojë sipas llojit, përdorimit dhe periudhës
- Opsioni **“Shiko detajet”** për më shumë informacione




tretek

# 8. Pagesa online

Për të paguar një faturë:

- Përdoruesi duhet fillimisht të **selektojë pronën** për të cilën dëshiron të kryejë pagesën, duke klikuar mbi **kartelën e pronës** në pjesën e sipërme të faqes.
- Pasi prona të zgjidhet, ajo do të paraqitet si **e selektuar**, duke treguar se të dhënat dhe faturat më poshtë i përkasin asaj prone.
- Më pas, përdoruesi duhet të shikojë pjesën ku paraqitet **fatura e fundit**.
- Klikoni butonin **“Paguaj tani”** për të vazhduar me procesin e pagesës.
- Pas këtij veprimi, përdoruesi dërgohet në hapat e mëtejmë për **përfundimin e pagesës së faturës** për pronën e zgjedhur.




tretek

# 8.1 Zgjedhja e shumës për pagesë

Për të zgjedhur shumën për një pagesë:

- Përdoruesi duhet fillimisht të **zgjedhë shumën për pagesë** duke:
  - E shkruar manualisht në fushën përkatëse, ose
  - Përzgjedhur një nga opsionet e gatshme, si:
    - **Pagesa e faturës së fundit**
    - **Pagesa e borxhit total**
- Pas përzgjedhjes së shumës, klikoni butonin **“Vazhdo te Pagesa”**.
- Me këtë veprim, përdoruesi vazhdon me **përfundimin e procesit të pagesës**.




tretek

# 8.2 Procesi i verifikimit të llogarisë bankare

Në përfundim të procesit të pagesës, përdoruesi duhet të shkruajë të dhënat e kartelës së përdoruesit, përfshirë emrin dhe mbiemrin, numrin e kartelës, datën e skadencës dhe kodin CVV/CVC, dhe më pas të klikojë butonin **“Paguaj”** për të përfunduar pagesën.



# 9. Njoftimet

Ky seksion paraqet njoftimet e përdoruesit, duke përfshirë informacione të rëndësishme si pagesat, faturat dhe mirëmbajtjet e planifikuara.
Çdo njoftim përmban titullin, përshkrimin dhe datën përkatëse, duke i mundësuar përdoruesit të jetë i informuar në kohë reale.



# 10. Cilësimet

Për të ndryshuar cilësimet e llogarisë, nga faqja kryesore klikoni te **“Cilësimet”** në anën e majtë.




tretek

# 10.1. Llogaria juaj

Në këtë seksion mund të ndryshoni të dhënat tuaja personale, si emri, mbiemri dhe numri i telefonit; të vendosni ose ndryshoni fotografinë e profilit; dhe të fshini llogarinë. Pas ndryshimeve, klikoni **“Ruaj ndryshimet”** për t’i ruajtur.




tretek

# 10.2. Menaxho pronat

Në këtë seksion shfaqen pronat tuaja të regjistruara, ku mund të shihni të dhënat e tyre, të shtoni pronë të re përmes butonit **“Shto pronë”**, ose të fshini një pronë ekzistuese përmes butonit të kuq në anën e djathtë.




tretek

# 10.3. Siguria e llogarisë

Në këtë seksion mund të ndryshoni email-in ose fjalëkalimin tuaj duke përdorur opsionet përkatëse si **“Ndrysho email-in”** dhe **“Ndrysho fjalëkalimin”**, dhe në fund klikoni **“Ruaj ndryshimet”**.



# 10.4. Cilësimet e njoftimeve

Në këtë seksion mund të aktivizoni ose çaktivizoni njoftimet për faturat, pagesat dhe përdorimin, duke përdorur butonat përkatës; pas zgjedhjes klikoni **“Ruaj ndryshimet”**.



# 10.5. Gjuha

Në këtë seksion mund të zgjidhni gjuhën e aplikacionit, njësinë e matjes dhe valutën, dhe pasi të bëni ndryshimet klikoni **“Ruaj ndryshimet”** për t’i ruajtur.




tretek

# 11. Çkyçja nga sistemi

Për t'u çkyçur nga sistemi, përdoruesi duhet të navigojë në anën e majtë të faqes, në pjesën e poshtme të menysë, dhe të klikojë në opsionin **"Çkyçu"**.




tretek